



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:070866

Datë: 19.04.2023

Numri i dokumentit: 04203963

SCC-11-0132

Paditësja

K e H të E.

Kundër

E Paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit – Rruga "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Hasim Sogojeva gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur me 19 prill 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia e paditëses hedhet poshtë.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 08 prill 2011, paditësja paraqiti padi kundër të paditurës me të cilën e kundërshton privatizimin e F "Sh C", në Han të Elezit.

Paditësja ka theksuar se ajo është posedues e fabrikës Sh C nga baza juridike se ajo gjendet në territorin e K se H të E. Ka pohuar se nuk kishte një konkurrim të denjë me rastin e privatizimit pasi që nuk është siguruar dhe arritur një çmim i drejtë. Pretendon se AKP për veç çmimit të ulet dhe pa konkurrencë në tenderim nuk ka marr në konsideratë edhe investimet e mundshme, punësimin i cili parashihet me dispozitat ligjore, garantimin e numrit të punëtoreve, si dhe ankesat e tyre që do të pasojnë. Ka shtuar se tani ankesat e punëtoreve dhe protestat e tyre kanë

mbetur barrë e K së H të E dhe të punësuarve të saj. Nisur nga fakti se F në fjalë ka një perspektive të qartë për ti mbijetuar procesit të privatizimit, K e H të E, është detyruar që në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 27 janar 2011, të merr vendim mbi ngritjen e padisë kundër AKP-se, ngase punëtorët e fabrikës dhe popullsia e Komunës nuk mund të privohen në mënyrë arbitrare nga prona e saj.

Paditësja tutje ka pohuar se të gjitha rastet e privatizimit të N.SH-se kanë kaluar në procedurat e parapara ligjore duke filluar nga vala e privatizimit, rregullat e tenderit, orari i tenderimit, njoftimin për tender, etj. Ndërsa në rastin e shitjes së fabrikës Sh C të gjitha procedurat kanë qenë të mbyllura dhe se është marr vetëm në konsideratë kontrata mbi qiranë e datës 13 qershor 2000, e lidhur në mes të AKM-së dhe Sh B g. Po ashtu janë shkelur edhe kushtetuta e RKS, ligjet dhe rregulloret.

Me 19 shkurt 2016 e paditura përmes mbrojtjes e ka kundërshtuar padinë dhe pretendimet e paditëses si të pa bazuar në ligje duke theksuar se paditëses i mungon legjitimiteti aktiv për procedimin e çështjes gjyqësore, ngase nuk ka qenë qeverisëse në këtë ndërmarrje. Ka shtuar se sipas ligjit për AKP-në vetëm AKP-ja ka kompetencë të administrojë me ndërmarrjen shoqërore deri në shtijën e tyre pa ndërhyrjen e subjekteve politike apo organeve e pushteteve tjera në Kosove.

AKP-ja gjithashtu ka theksuar se paditësja nuk specifikon se cilat dispozita ligjore janë shkelur, nga ana e AKP-së. AKP-ja i ka propozuar gjykatës që padinë e paditëses ta refuzoj si të pa bazuar.

Me 03 prill 2023, Dhoma e Posaçme, në këtë çështje ka caktuar seancë dëgjimore, dhe me urdhër ka kërkuar nga Komuna e Hanit të Elezit që në afat prej 7 ditësh të parashtrojë autorizimin për përfaqësim komfor dispozitës së nenit 32.1 dhe 32.4 të Ligjit numër 06/L-086 për DHPGJS-në, duke e njoftuar se paditësja në seancën dëgjimore mund të përfaqësohet vetëm nga një avokat i Licencuar i Odes së Avokatëve të Kosovës. Me urdhër paditësja është njoftuar edhe për pasojat në rast të mosparaqitjes së saj në seancën e caktuar dëgjimore. Urdhri dhe thirrja për seancë i janë dorëzuar paditëses në mënyrë të rregullt.

Me 19 prill 2023, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i palës së paditur AKP-së, ndërsa nuk ka prezantuar paditësja, e cila është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar. Përfaqësuesi i të paditurës, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të nxjerrë aktgjykim për mosparaqitje.

Arsyetimi ligjor:

Padia e paditëses hedhet poshtë.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjërs mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 19 prill 2023, në ora 9:30, Dhoma e Posaçme ka mbajtur seancë dëgjimore në këtë çështje juridike. Gjykata konstaton se urdhri për seance është pranuar në mënyrë të rregullt nga pala paditëse dhe e paditura, gjë që vërtetohet nga fletë kthesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Paditësja nuk kanë prezantuar në seancë dhe nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë për shtyrjen e seancës. Përfaqësuesi i të paditurës (AKP), i ka propozuar gjykatës që në përputhje me Ligjin për Dhomën e Posaçme të sjell aktgjykim për mosparaqitje.

Pasi që Dhoma e Posaçme nuk ka pranuar asnjë njoftim nga pala paditëse me të cilin do të theksonte arsyet apo rrethanat se pse nuk ka prezantuar në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të paditurës – AKP, që të merret Aktgjykim për mosparaqitje, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykimi të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Paditësi e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar, andaj nuk ngarkohet me taksë shtesë.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar kryesues

Hajrie Shala, Gjyqtare

Hasim Sogojeva, Gjyqtar